

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE
PËRGJEGJËS/E PËR ZYRËN MARKETING**

Pozicioni: Përgjegjës/e i/e Zyrës Marketing dhe Marrëdhënie me Publikun

Tipologjia: Me kohë të plotë

Data e fillimit: Nëntor 2024

Afati i aplikimit: Tetor 2024

Rreth UMT

Universiteti Metropolitan Tirana është universitet i çertifikuar nga MAS i përbërë nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi e veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe SHBA.

Pozicioni vakant

Universiteti Metropolitan Tirana po kërkon të rekrutojë Përgjegjës/e të Zyrës Marketing dhe Marrëdhënie me Publikun.

Kriteret kryesore për të aplikuar për pozicionin janë si më poshtë:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë (Marketing, Menaxhim/Administrim Biznesi, Shkenca Sociale)
- Të ketë mbi 5 vjet eksperiencë në fushën e marketingut
- Preferohet me të paktën 3 vjet eksperiencë pune në fushën e arsimit të lartë
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze
- Të ketë aftësi të forta organizative dhe bashkëpunuese
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të ekipit.
- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikuese.

Aplikimi

Kandidatët duhet të dërgojnë në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:

- CV (Curriculum Vitae)
- Letër motivimi

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al

Pas selektimit do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.